

Aktivitetet e Qendrës Kulturore në Suedi me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti –Skënderbeu, dhe festës së Pavarësisë së Kosovës

Viti i Gjergj Kastriotit

Në Qendrën Kulturore të Kosovës në Suedi, në fillim shkurti të vitit 2018, u kujtua me respekt të madh heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti. Viti 2018, me të drejtë, u pagëzua Viti i Gjergj Kastriotit- Skënderbeut.

Kështu, më 2 e 3 shkurt 2018, Qendra Kulturore e Kosovës në Suedi, në bashkëpunim me Ambasadën e Shqipërisë në Danimarkë, organizoi ekspozitën e librave për Skënderbeun.

Ekspozita me libra të rrallë e të vjetër e koleksionistes angleze, Patricia Robo, u përrua së pari në Kopenhagë (Danimarkë), nga ambasadori i Ambasadës së Kosovës në Danimarkë, Kastriot Robo.

Për dy ditë, sa qëndroi e ekspozuar në këtë qytet, ekspozitën e vizituan qytetarë të vendeve skandinave. Ditën e parë, para ambasadorëve e pjesëmarrësve kureshtarë, ligjëroi akademikja daneze Minna Skaftte Jensen, e cila ndriçoi autoritetin humanist të shkrimtarit Marin Barleti dhe arsyen e përkthimit të veprës së tij historike për Skënderbeun në të gjitha gjuhët e Evropës.



Pas dy ditësh, ekspozita- koleksion me 36 vepra për Skënderbeun- u ekspozua në Malmo (Suedi).

Më 4 shkurt, Qendra Kulturore e Kosovës në Suedi dhe Ambasada e Shqipërisë në Danimarkë bashkërisht shpallën vitin 2018 “Vit Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit”.


Drejtori i Qendrës Kulturore, Naim Sadiku, e hapi ekspozitën -koleksion të zonjës Patricia Nugge, e cila zgjoi interesim të madh te bashkatdhetarët tanë. Librat e rrallë, të paraqitur në këtë ekspozitë, ishin botime të shekujve XVI e XVII, ndërkaq më i vjetri, i vitit 1510, ishte “Historia e jetës dhe e veprës së Gjergj Kastriotit” i Barletit, në latinisht. Mes veprave

interesante për Skënderbeun ishte edhe ai i filozofit danez Ludvig Holberg, i botuar në Kopenhagë, në vitin 1742, si dhe një tjetër në suedisht, i botuar në Stokholm, më 1788. Koleksionistja e kësaj ekspozite, Nugge, foli për interesimin e vazhdueshëm për figurën e Skënderbeut dhe për dashurinë që ka për ruajtjen e veprave për këtë personalitet të madh të historisë shqiptare.

Tash 35 vjet, -tha Nugge,- kërkoj pa përtesë kujtesën e shkruar gjithandej për Skënderbeun”. Ajo sot e konsideron thesar koleksionin e vet, thesar që e shpalos me kujdes e dashuri nëpër kryeqendra botërore.



Patricia Nugge



Tue Magnusen, profesor universitar dhe njohës i hollë problemeve të Ballkanit, shqyrtoi aspekte të veprës së filozofit danez Ludvig Holberg, i cili Skënderbeun e vlerësonte generalin më të famshëm të Evropës. Ndërkaq, ambasadori Kastriot Robo konstatoi se figura e Skënderbeut shndrit gjithë historinë tonë, ndërsa emri i tij ishte burim frymëzimi për të gjitha letërsitë e Evropës e më gjerë. Edhe dr. Muhamet Shatri, në ligjërimin e tij, foli për figurën e Skënderbeut.

Sa i përket pjesës artistike, sopranoja Feride Istogu Gillsberg kujtoi shkëlqyeshëm Motin e Madh të Gjergj Kastriotit përmes këngës "O ju male".

Të gjitha aktivitetet kulturore të Qendrës për sivjet do të zhvillohen në shenjë të Vitit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut.



17 shkurt 2018

Festa e Pavarësisë

Më 17 shkurt 2018, Qendra Kulturore e Kosovës në Suedi organizoi një program festiv për nder të 10-vjetorit të Pavarësisë. Në prani të shumë mërgimtarëve, përfaqësuesve të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, përfaqësuesve nga Ambasada e Kosovës në Suedi, ndër ta edhe miq danezë e studentë suedezë, programi nisi me intonimin e himnit shtetëror të Kosovës. Më pas, drejtori i Qendrës, Naim Sadiku, i përshëndeti të pranishmit dhe u uroi 10-vjetorin e Pavarësisë. Për vlerat historike të 17 Shkurtit foli veprimtari Ibrahim Xhemajli.

Z.Faruk Nura, zëvendësministër i Diasporës dhe i Investimeve Strategjike, i pranishëm në këtë ngjarje, vlerësoi kontributet e hershme të Diasporës për çlirim, duke veçuar sukseset që fëmijët e Kosovës arrijnë nëpër botë. Më pas, mori fjalën ambasadori i Shqipërisë në Danimarkë, Kastriot Robo. Fjalë rasti mbajtën edhe Naim Memeti, ambasador i Maqedonisë në Danimarkë, Mustafë Bajramaj, kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së për Suedi, dr. Muhamet Shatri dhe prof. Rexhep Jashari. Edhe danezi Tue Magnusen, profesor universiteti në Kopenhagë, ua uroi shqiptarëve Pavarësinë, këtë pavarësi që, përmes shkrimeve të veta publicistike, e kërkonte që në vitet e nëntëdhjeta.



Pjesa e dytë- programi kulturor

Pjesa e dytë e këtij programi u karakterizua me paraqitjen e nxënësve dhe këngëtarëve shqiptarë që jetojnë e punojnë në Suedi. Recituan poezi dhe kënduan për Kosovën nxënëset Lorena Berisha e Leona Hykollli nga shkolla shqipe e Eslövit me mësues Rashit Berisha, nxënësit nga shkolla e Helsingborgut me mësuese Emine Jashari, nxënësit Leart Sejdiu e Andi Rrustemi, Altina Gashi e Aulona Rrustemi. Nxënësit recitues i shoqëroi me violinë profesori Rexhep Jashari.

Pjesën muzikore e nisi këngëtarja dhe poetja Afërdita Xani, e cila i këndoi dy këngë, për të vazhduar me Lulzim Ramën, Selvie Vehapin e Hamdi Goxhulin, të cilët i kënduan Kosovës, Shqipërisë e Skënderbeut. Edhe rapsodi Enver Ismaili këndoi me çifteli, duke sjellë para publikut lavdinë historike të Kosovës. Pjesën solistike e përfundoi Fahrie Jashari me dy këngë popullore. Kurse programi festiv mbaroi me një valle, luajtur nga grupi i orkestrës "Okarina", nën drejtimin artistik të profesor Bashkim Jasharit.

